



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0554

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga; Isa Hasani-kryetar, Vedat Poterqoi-anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani, anëtare duke vendosur sipas ankesës së OE “Ejona” Sh.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontrate lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e Komunës së Prishtinës dhe Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e banimit kolektiv”, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Kuvendi i Komunës së Prishtinës, 24/11/2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Ejona" SH.P.K. me nr. 2023/0554, e datës 07/08/2023, kurse vendimi i AK Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e Komunës së Prishtinës dhe Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e banimit kolektiv" me numër të prokurimit, "616-23-4207-2-1-1", LOT 1, anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar. të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.04.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e Komunës së Prishtinës dhe Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e banimit kolektiv” me nr. të prokurimit: "616-23-4207-2-1-1". Ndërsa me datën 20.07.2023 ka

publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku ka shpërblyer me kontratë OE "Selmans Network & Ramoy Lift" Sh.P.K, për Lot 1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 650,000.00 €.

Me 25.07.2023, OE "Ejona" Sh.P.K. ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 26.07.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 07.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Ejona" Sh.P.K me nr. 554/23 për lidhur me aktivitetin "Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e Komunës së Prishtinës dhe Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e banimit kolektiv" me nr. të prokurimit: "616-23-4207-2-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet ankimore të OE "Ejona" Sh.P.K."- në vijim.

Pretendimi i parë (I): OE i rekomanduar "Selmans Network & Ramoy Lift" nuk ka përmbushur kërkesat në DT, mbi kërkesat profesionale dhe teknike sipas pikës 2 dhe 3. OE nuk i posedon Certifikatat për Iso Standardet që lidhen me natyrën e aktivitetit mirëmbajtës e ashensorëve si; ISO 9001 2015; b) ISO 14001 2015; c) ISO OHSAS 18001,

Po ashtu mungojnë referencat lidhur me menaxhimin e kontratave, për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për inxhinierin e elektroteknikës dhe inxhinierin e makinerisë".

Pretendimi i dytë (II): Grupi i OE "Selmans Network & Romay" kanë ofruar me çmime jo-normalisht të ulëta. Ka ofertuar me çmime absurde të ulëta të cilat nuk mbulojnë as kostot e transportit, e lëre më kostot e prodhimit, pagave minimale sipas LPP.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Raporti i ekspertit shqyrtues

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 04/10/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 554/2023, ndërsa me datë 17/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit si në vijim;

Raporti i ekspertit shqyrtues, pasi analizimit të pretendimit të pare ankimor lidhur Certifikatat ISO Standardet e Liderit te grupit, vlerëson se qëndron pretendimi i OE ankues, për faktin se i rekomanduari për kontrate ka dorëzuar dy certifikata ISO standarde, të lëshuara me datën njëra me 28.4.2021 dhe tjetra me datën 8.09.2022 në të cilat jepet një përshkrim i përmbajtjes i validitetin të tyre për shërbimet, por në asnjërin nuk përmendet konkretisht shërbimi mirëmbajtja e ashensorëve. Vlen të përmendet fakti se anëtari i dytë i konzorciumit :Romay Lift SH.P.K., ka dorëzuar Certifikata , Iso Standardet, pikërisht për mirëmbajtje të ashensorëve. Megjithatë eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja, është dashur të verifikojë sipas nenit 72 të LPP-se, sepse përshkrim të ISO standardit të dorëzuar nga i rekomanduari për kontrate, thuhet: Pra, nga përshkrimi i dhënë me lartë, nënkuptohet se i rekomanduari për kontrate është i certifikuar edhe për aktivitete tjera të specializuara në ndërtim, që mund të nënkuptohen se përfshihet edhe pjesa e mirëmbajtjes së ashensorëve. Pra, certifikatat e dorëzuara nuk japin një përshkrim me të detajuar se janë edhe për mirëmbajtje të ashensorëve. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se verifikimi është i nevojshëm. OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontrate nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontrate.

AK-ja në DT ka kërkuar për stafin profesional, konkretisht për inxhinierin e elektros, që i njëjti duhet të ketë menaxhuar kontrata të natyrës së ngjashme. Eksperti shqyrtues, sqaron se në CV-in e tij nuk ka emërtuar asnjë projekt që inxhinieri i elektros i dorëzuar në ofertën e të rekomanduarit për kontrate ta ketë menaxhuar ndonjë kontrate të natyrës së ngjashme dhe po ashtu edhe në referencat të cilat vet OE Selmans Network i ka lëshuar për inxhinierin e vet, nuk e ka përmendur se i njëjti ka qenë menaxher në ndonjë projekt të ngjashëm. Prandaj ky pretendim i OE ankues qëndron. Po ashtu qëndron pretendimi i OE ankues edhe sa i përket inxhinierit i makinerisë lidhur me udhëheqjen e projekteve të ngjashëm si të inxhinieri i elektros ka kërkuar që edhe inxhinieri në fjalë të ketë menaxhuar projekte të ngjashme, dhe nga dëshmitë e prezantuara nuk figuron se i njëjti ka menaxhuar.

OE ankues, në ankesën e tij pretendon se i rekomanduari për kontrate, ka ofruar çmime Jo/Normalisht të ulëta, duke u çekur disa pozicione të paramasës së tij. Eksperti shqyrtues, vlerëson se në bazë të nenit 61 të LPP-se, vlerësimi i çmimeve është e drejtë e autoritetit kontraktues dhe njëherit sqarohet se OE ankues nuk ka ofruar ndonjë prove bindëse lidhur me çmimet për të cilat pretendon AK-ja,

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertes mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e gjetjeve të raportit të ekspertes. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ejona” Sh.P.K. janë të bazuara.

Po që se autoriteti kontraktues kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë

Paneli shqyrtues lidhur me pohimin ankimore për mungese të Certifikatave ISO nga OE i rekomanduar, vrene se neni 26.6 i Rregullores për Prokurim Publik nr.01/2022, përcakton”*Çertifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse.*”

Po ashtu paneli vren se neni 70 i Ligjit të Prokurimit Publik përcakton se “*Po qe se autoriteti kontraktues kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, autoriteti kontraktues do t’u referohet sistemeve për sigurimin e cilësisë që: (i) bazohen në standardet përkatëse Kosovare, Evropiane ose ndërkombëtare dhe (ii) të certifikuara nga organet që kryejnë veprimtaritë e tyre në pajtim me ato standarde për ushtrimin e aktiviteteve të tyre të certifikimit lidhur me aktivitetet e certifikimit*”

Paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar nuk i ka plotësuar kërkesat e pikës 3 ,Kërkesat dhe mundësit teknike e profesionale te DT, pasi OE i rekomanduar nuk i ka dorzuar Certifikatat ISO Standardet e Liderit te grupit, çertifikata këto të cilat nuk përkojnë me kërkesat e DT për mirëmbajte të ashensorë, e cila është kërkesë e rregullores se cituar, po ashtu, parashihet se secili anëtar i grupit duhet të dëshmojnë standardet përkatëse, kërkesë kjo e cila është e ndërlidhur me nenin 70 të LPP dhe me cilësit që duhet të posedojë OE, andaj, konform nenit 26.6 të RRPP, OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e përcaktuar në Dosje të Tenderit. Kjo çështje është e sqaruar edhe në interpretimin e nxjerru nga KRPP më 22.06.2023, i renditur me nr. rendor 29, dhe i cili është i publikuar ne ueb faqen e eprokurimit.

Ndërsa sa i përket pohimit ankimor për mungese referencave lidhur me menaxhimin e kontratave, për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për inxhinierin e elektroteknikës dhe inxhinierin e makinerisë. DT ka kërkuar 5 vite përvojë të punës pas diplomimit, dhe të kenë menaxhuar kontrata te punës së ngjashme, por nuk ka caktuar numrin e kontratave të menaxhuara, një reference përmbushe kërkesën. Paneli shqyrtues ka vrenjtur se inxhinierët kane përvojë të punës e po ashtu në dokumentet e tyre, kanë referenca për menaxhim te kontratave.

Paneli Shqyrtues sa i perket pohimeve ankimore OE i rekomanduar ka ofruar çmime jo-normalisht te ulëta duke u bazuar në të dhënat e këtij aktiviteti, të llojit të procedurës së hapur, konstaton se, OE ankues nuk ka ofruar dëshmi argumente dhe të dhëna konkrete që dërgojnë të vërtetimi i pretendimit apo klasifikimin e tij si i bazuar, ndërsa mbete në diskrecion e AK-së (sipas dispozitave të LPP-së) që në këtë rast, duke pasur parasysh instrumentet ligjore që mund ti përdorë para dhe përgjatë implementimit të kontratës, siç janë rritja e sigurimit të ekzekutimit, menaxhimi i saj sipas kriterëve standardeve të përcaktuara paraprakisht, e po ashtu bazuar në çmimet e ofertuara të krijojë bindjen se oferta e OE të rekomanduar nuk ka hapësirë manipulimesh si dhe krijim të vështirësive në implementim të kontratës.

Paneli rikujton se të gjitha autoritetet publike, zyrtarët që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellën duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të

ligjit.

Po ashtu Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, i LPP-së përcakton se të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e eksperteve shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e Komunës së Prishtinës dhe Mirëmbajtja e ashensorëve për objektet e banimit kolektiv” me nr. të prokurimit: "616-23-4207-2-1-1", të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit. Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " EJONA " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: